



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

# **Zbatimi i Rekomandimeve, të lëna gjatë vitit 2022**

**Janar 2024**



+355 4 2247294



[www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al)



# PËRMBAJTJA

<b>1</b>	HYRJE	<b>05</b>
<b>2</b>	PËRMBLEDHJA E REZULTATEVE	<b>07</b>
<b>3</b>	DISA FAKTORË QË NDIKOJNË NË ZBATUESHMËRINË	<b>08</b>
<b>4</b>	REZULTATET SIPAS SUBJEKTEVE	<b>09</b>
<b>5</b>	PËRMBAJTJA E TABELAVE	<b>58</b>





## POPULLATA E AUDITIMIT

### Gjithsej 95 auditime

- 14 Auditime përputhshmërie
- 12 Auditime financiare
- 42 Auditime të kombinuara
- 5 Auditime IT
- 19 Auditime performance
- 3 Auditime tematike

### Gjithsej 3186 rekomandime

- 2164 Masa organizative
- 42 Përmirësime ligjore
- 567 Efekte financiare (në numër)
- 341 Masa disiplinore
- 72 Masa administrative

 Gjatë procesit të verifikimit të zbatimit të rekomandimeve, puna e KLSH mbështetet në:

“Kompetencat e Institucioneve Supreme të Auditimit” parashikuar në INTOSAI-P 1 “Deklarata e Limës”, ku parashikohet se subjekti i audituar duhet të komentojë mbi rezultatet e auditimit brenda një periudhe kohe të vendosur me ligj ose nga SAI, si dhe të paraqesë masat e marra për zbatimin e rekomandimeve.

Deklaratën e Meksikos, konkretisht në INTOSAI-P 10 “Mbi pavarësinë e SAI-eve”, INTOSAI-P 11 “Ekzistenca e mekanizmave të ndjekjes së rekomandimeve të SAI-t”. INTOSAI-P 12 “Vlerat dhe përfitimet e SAI-eve - të bësh diferencën në jetën e qytetarëve”.

Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në nenet 15 dhe 30 të të cilit parashikohet periudha e kthimit të përgjigjies si dhe drejta e KLSH për t’iu drejtuar organeve më të larta të kompetencës në rast të moszbatimit të rekomandimeve të lëna.

## OBJEKTIVAT

Performanca institucionale nuk mund të arrihet pa konsolidimin e një sistemi efektiv të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve dhe kjo është rruga e vetme e përbushjes së qëllimeve strategjike të misionit dhe vizionit institucional, si dhe pritshmërie të Kuvendit, publikut dhe gjithë palëve të interesit. Sa më sipër gjithashtu në linjë me objektivin strategjik nr. 2të KLSH , nëpërmjet të cilit KLSH synon të rrisë impaktin e punës audituese dhe të kontribuojë në mirëqeverisje, përgjegjshmëri, llogaridhënie dhe transparencë të fondeve publike, nëpërmjet dhënies së rekomandimeve të qarta dhe të orientuara drejt veprimeve konkrete

## ROLET

Kërkesat e Kornizës së Deklaratave Profesionale të INTOSAI (IFPP), përcaktojnë qartë rolet e përgjegjësive të subjekteve të audituara dhe Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI-eve), sipas të cilave është thelbësore që përgjegjësia për implementimin e rekomandimeve në kohë dhe me efektivitet është e subjekteve të audituara; por nga ana tjetër është përgjegjësi e SAI-ve ndjekja e zbatimit të rekomandimeve, pra verifikimi nëse veprimet e ndërmarra i shërbejnë rezultatve të pritshme.

## PËRFITIMET

Procesi për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve dhe inicimi e zbatimi i masave korigjuese nga subjektet e audituara, jep një informacion të detajuar mbi vlerën e shtuar që sjell puna e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe njëherazi jep garanci për profesionalizmin, pavarësinë dhe objektivitetin e institucionit.

Konsolidimi i një mekanizmi efektiv të verifikimit sistematik dhe raportimit të zbatimit të rekomandimeve, bazuar në metodologji dhe procedura të standardizuara, të qarta dhe të mirë detajuara, i lejon jo vetëm Kontrollit të Lartë të Shtetit por dhe palëve të treta Kuvendit, Qeverisë etj, të sigurojnë në vijimësi, një informacion të plotë, lidhur me veprimet e ndërmarra nga ana e subjekteve të audituara për hartimin e dokumenteve strategjike në nivel institucional dhe kombëtar apo për iniciativa për ndryshime ligjore, administrative dhe organizative.


Skemat dhe qasja e përdorur për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, synojnë të gjenerojnë indikatorë të konsoliduar institucional, sa i takon pranueshmërisë dhe zbatueshmërisë së rekomandimeve, duke mundësuar në këtë mënyrë rritjen e mbikëqyrjes parlamentare nga ana e Kuvendit ndaj ekzekutivit, me efekt rritjen e përgjegjshmërisë së menaxhimit të fondeve publike.



Nga verifikimi mbi respektimin e afateve ligjore për kthimin e përgjigjes 20 ditore, rezultoi se:

- në zbatim të nenit 15, pika j, e ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", 68 subjekte kanë kthyer përgjigje brenda afatit ligjor 20 ditor, mbi statusin e rekomandimeve të lëna;
- dhe 27 subjekte nuk kanë kthyer përgjigje, në kundërshtim me nenin 30, pika 2, e ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

nuk kanë kthyer përgjigje brenda 20 ditëve 28%




Burimi: Shkresat dërguar nga subjektet

Nga verifikimi mbi respektimin e afateve ligjore për kthimin e përgjigjes 6 mujore, rezultoi se:

- në zbatim të nenit 30, pika 2, e ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", 50 subjekte kanë kthyer përgjigje brenda 6 muajve, mbi statusin e rekomandimeve të lëna
- 45 subjekte nuk kanë kthyer përgjigje, në kundërshtim me nenin 30, pika 2, e ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"


nuk kanë kthyer përgjigje brenda 6 muajve 47%



Burimi: Shkresat dërguar nga subjektet

Referuar përgjigjeve sa më sipër, dhe më pas edhe verifikimit të tyre në terren, rezultoi se nga 3186 rekomandime të lëna gjithsej, gjatë vitit 2022, 3077 rekomandime janë pranuar, ose rreth 97% e total rekomandimeve; dhe nuk janë pranuar 109 rekomandime, ose rreth 3% e tyre.

## Infografik nr. 1: Pranueshmëria e rekomandimeve



Burimi: Verifikimet nga KLSH

Në përfundim, rreth 73% e masave rezultuan të zbatuara plotësisht, pjesërisht dhe në proces zbatimi. Konkretisht, nga total 3077 masa të pranuar, 1226 masa rezultuan të jenë zbatuar plotësisht (ose rreth 40% e total masave të pranuar), 325 masa zbatuar pjesërisht (ose rreth 11% e total masave të pranuar), 690 në proces zbatimi (ose rreth 22% e total masave të pranuar) dhe 836 masa janë ende pa zbatuar (ose rreth 27% e total masave të pranuar).



## 2. PËRMBLEDHJA E REZULTATEVE

Nga verifikimet e kryera për 95 auditime të kryera nga KLSH, lidhur me nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna gjatë vitit 2022, rezultoi se janë dhënë gjithsej 3186 masa (që përfshijnë 42 përmirësime ligjore, 2164 masa organizative, 197 masa shpërblim dëmi, 370 masa për shpenzime pa eficiencë, efektivitet dhe ekonomikitet, 72 masa administrative dhe 341 masa disiplinore), nga të cilat janë pranuar 3077 masa, ose 97%; dhe nuk janë pranuar 109 masa, ose 3%.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezultoi se nga 3077 masa të pranuar, janë zbatuar (plotësisht dhe pjesërisht) 1551 ose 50.4%; janë në proces zbatimi 690 ose 22.4%; dhe 836 masa nuk janë zbatuar ose 27.2%. Më konkretisht:

- A.** Rekomanduar gjithsej 42 "Masa për përmirësime ligjore", nga të cilat janë pranuar 41 masa ose 98% dhe nuk është pranuar 1 masë ose 2%. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezultoi se nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 22 masa ose 54%, pjesërisht 2 masa ose 5%, janë në proces zbatimi 12 masa ose 29% dhe nuk janë zbatuar 5 masa ose 12%.
- B.** Rekomanduar gjithsej 2164 "Masa organizative", nga të cilat janë pranuar 2082 masa ose 96% e tyre dhe nuk janë pranuar 82 masa ose 4%. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezultoi se nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 887 masa ose 43%, zbatuar pjesërisht 218 masa ose 10%, janë në proces zbatimi 489 ose 23.5% dhe nuk janë zbatuar 488 ose 23.5% e tyre.
- C.** Rekomanduar 197 "Masa për shpërblim dëmi (në numër)" nga të cilat janë pranuar 189 masa ose 96% dhe nuk janë pranuar 8 masa ose 4%. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezultoi se nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 67 masa ose 35%, pjesërisht 24 masa ose 13%, janë në proces zbatimi 51 masa ose 27% dhe nuk janë zbatuar 47 masa ose 25%.
- D.** Rekomanduar 370 "Masa për eliminimin e efekteve negative (në numër)" nga të cilat janë pranuar 357 masa ose 96% dhe nuk janë pranuar 13 masa ose 4%. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezultoi se nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 64 masa ose 18%, pjesërisht 48 masa ose 13%, janë në proces zbatimi 113 masa ose 32% dhe nuk janë zbatuar 132 masa ose 37%.
- E.** Rekomanduar 341 "Masa disiplinore" nga të cilat janë pranuar 337 masa ose 99% dhe nuk janë pranuar 4 masa ose 1%. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezultoi se nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 149 masa ose 44%, pjesërisht 32 masa ose 9%, janë në proces zbatimi 24 masa ose 7% dhe nuk janë zbatuar 132 masa ose 39%.
- F.** Rekomanduar 72 "Masa administrative" nga të cilat janë pranuar 71 masa ose 99% dhe nuk është e pranuar 1 masë ose 1%. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezultoi se nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 37 masa ose 52%, pjesërisht 1 masë ose 1%, është në proces zbatimi 1 masë ose 1% dhe nuk janë zbatuar 32 masa ose 45%.



### 3. DISA FAKTORE QE NDIKOJNE NE % E ZBATUESHMERISE

Pavarësisht verifikimit të zbatimit të rekomandimeve dhe rezultateve të konstatuara nga KLSH dhe të paraqitura në këtë raport, procesi në vetvete mbart disa kufizime, të cilat mund të ndikojnë në rritjen e treguesit “pa zbatuar”, “në proces zbatimi” dhe “pjesërisht”, dhe që duhen mbajtur në konsideratë në vijim.



Ndryshe nga auditimet tradicionale financiare ose të pajtueshmërisë, auditimet e performancës fokusohen në vlerësimin e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit të operacioneve ose programeve të një ose më shumë institucioneve publike, pjesë e të njëjtit sistem/proces. Si rezultat, rekomandimet që rrjedhin nga auditimet e performancës shpesh kërkojnë ndryshime të shumëanshme që përfshijnë sisteme, procese ose politika komplekse. Këto auditime shkojnë përtej identifikimit të thjeshtë të çështjeve; ato analizojnë shkaqet kryesore, propozojnë zgjidhje gjithëpërfshirëse dhe shpesh kërkojnë ristrukturim ose riinxhinierim të rëndësishëm për t'u zbatuar në mënyrë efektive.

Rrjedhimisht, zbatimi i rekomandimeve nga auditimet e performancës kërkon një proces më të ndërlikuar që kërkon kohë dhe që përfshin bashkëpunimin e palëve të interesuara, shpërndarjen e burimeve, rregullimet e politikave dhe ndonjëherë ndryshime legjislative ose organizative.

Kjo natyrë e ndërlikuar e adresimit të përmirësimeve sistemike kontribuon në një afat kohor më të zgjatur të zbatimit të rekomandimeve në auditimet e performancës, në krahasim me llojet e tjera të auditimit. Në vijim të sa më sipër, rreth 38% e rekomandimeve të lëna gjatë vitit të mëparshëm në auditimet e performancës, edhe pse pranuar në masën 98%, rezultuan ende në proces zbatimi (26%) dhe të realizuara pjesërisht (12%), pikërisht sepse implementimi i tyre merr më tepër kohë.



Auditimet IT, gjithashtu kërkojnë më shumë kohë për tu zbatuar në krahasim me auditimet tradicionale financiare ose të pajtueshmërisë, për shkak të kompleksitetit të sistemeve. Zbatimi i këtyre rekomandimeve shpesh kërkon burime të dedikuara, duke përfshirë personelin e kualifikuar dhe financimin. Departamentet e TI-së mund të kenë nevojë të ripërcaktojnë detyrat dhe të ndajnë burime shtesë për të adresuar rekomandimet në mënyrë efektive. Njëkohësisht zbatimi i ndryshimeve në sistemet e TI-së mund të mbart risqe të tilla si: ndërprerja, humbja e të dhënave ose cënueshmëria e sigurisë, kështu që ekipet e TI duhet të vlerësojnë këto rreziqe dhe të planifikojnë në përputhje me rrethanat për të minimizuar ndikimet e mundshme negative.



Gjithashtu mund të ketë edhe rekomandime, të cilat me kalimin e kohës, mund të rezultojnë jo relevante për shkak të ndryshimeve të diktuar së jashtmi, dhe për pasojë nuk mund të zbatohen më.



### 4. REZULTATET SIPAS SUBJEKTEVE

#### 1. Kuvendi i Shqipërisë

Nga auditimi i ushtruar në Kuvendin e Shqipërisë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi Auditimin e Përputhshmërisë" për periudhën 01.01.2017 deri më 30.04.2022 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 190, datë 04.10.2022, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 350/7 prot., datë 04.10.2022, rezulton se:

- Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.
- Kuvendi i Shqipërisë, në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, ka përgatitur planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 2 masa për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në Fuqi nga ku 2 rekomandime, janë pranuar plotësisht 2 rekomandime dhe janë zbatuar plotësisht;
- b) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 11 rekomandime masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 11 rekomandime të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 9 zbatuar dhe 2 në proces zbatimi.

#### 2. Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë" për periudhën 01.01.2019 deri më datën 31.03.2022 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 131, datë 28.07.2022, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 380/11, datë 29.07.2022, rezulton se:

- Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.
- Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, ka përgatitur planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga Titullari brenda afatit 6 mujor, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 8 masa organizative, janë pranuar dhe zbatuar plotësisht 8 rekomandimet;
- b) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 2 masa shpërblim dëmi, janë pranuar dhe zbatuar plotësisht të dy 2 rekomandimet.



### 3. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi auditimin e përputhshmërisë dhe vlerësues me fokus Planin Kombëtar të Deinstitutionalizimit të Fëmijëve 2020-2022" për periudhën 01.09.2020 deri më datën 31.11.2021 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr.29, datë 16.03.2021, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr.380/11, datë 07.06.2022, rezulton se:

- MSHMS ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, duke e dërguar në KLSH me 21 ditë vonesë, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.

- Në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nuk ka përgatitur planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 3 masa organizative, janë pranuar plotësisht 3 rekomandimet, nga të cilat: 2 Zbatuar, 1 në proces zbatimi;
- b) Për përmirësimin e gjendjes është lënë, 1 masë disiplinore nga ku 1 rekomandim, i cili është i papranuar. plotësisht 11 rekomandime të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 9 zbatuar dhe 2 në proces zbatimi.

### 4. Ministria e Arsimit dhe e Sportit

Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë" për periudhën e veprimtarisë nga data 01.09.2019 deri në 31.08.2021 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit me nr.933/13, datë 04.04.2022, dhe vendimit të Kryetarit të KLSH-së, rezulton se:

- Ministria e Arsimit dhe e Sportit ka hartuar një procesverbal të mbajtur në datën 25.02.2022, me nr. 2642/45 prot, dërguar në KLSH në lidhje me temën "Për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga projekt raporti i auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit" kjo në përputhje me Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja 'j'.

- Ministria e Arsimit dhe e Sportit në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, ka përgatitur planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga Titullari brenda afatit 6 mujor, kjo në përputhje me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30, pika 2 e tij.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 25 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 25 rekomandime të cilat kanë statusin e ecurisë si vijon: 13 zbatuar, 3 të pazbatuar dhe 9 janë në proces zbatimi;
- b) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 3 masa për shpërblimin e dëmit, nga të cilat janë pranuar plotësisht, nga të cilat: 1 zbatuar dhe 2 në proces zbatimi;
- c) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 9 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin dhe menaxhimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike, nga të cilat janë pranuar plotësisht 9 rekomandime të cilat kanë statusin e ecurisë si vijon: 9 zbatuar;
- d) Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 masë disiplinore me 1 rekomandim, i cili është pranuar plotësisht dhe ka statusin e ecurisë i pazbatuar.



### 5. Mbi auditimin tematik në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit

Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë" për periudhën e veprimtarisë nga data 01.09.2019 deri në 31.08.2021 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit me nr.933/13, datë 04.04.2022, dhe vendimit të Kryetarit të KLSH-së, rezultojnë se:

- MAS ka hartuar një procesverbal në lidhje me temën "Për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga projekt raporti i auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit" kjo në përputhje me Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja 'j'.

- MAS në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, MAS ka përgatitur planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga Titullari brenda afatit 6 mujor, kjo në përputhje me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30, pika 2 e tij.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimi dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 3 masa për përmirësim Ligjor, nga të cilët janë pranuar plotësisht 3 rekomandime, nga të cilat: 1 zbatuar dhe 2 në proces zbatimi;
- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 5 masa organizative, nga të cilët janë pranuar plotësisht 5 rekomandime të cilat kanë statusin e ecurisë si vijon: 4 zbatuar dhe 1 i pa zbatuar.

### 6. Ministria e Kulturës

Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë e Kulturës për zbatimin e rekomandimeve të KLSH mbi "Auditimin financiar dhe të përputhshmërisë" për periudhën 01.01.2020 deri më datë 31.12.2021 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr.113, datë 15.07.2022, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1420/24 prot., datë 18.07.2022, rezultojnë se:

- Ministria e Kulturës ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, kjo në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.

- Ministria e Kulturës në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, MK ka përgatitur planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari, por nuk e ka dërguar në KLSH, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimi dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- Për përmirësimin e gjendjes është lënë, 1 masë për Ndryshime apo Përmirësime në Legjisllacionin në fuqi me 1 rekomandim, i cili është i pranuar plotësisht dhe është i zbatuar;
- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 15 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 15 rekomandime, nga të cilat: 5 zbatuar, 5 në proces zbatimi dhe 5 të pazbatuar;
- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 2 masa për shpërbllim dëmi, nga të cilët janë pranuar plotësisht te 2 rekomandimet dhe janë zbatuar;
- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 7 masa për menaxhimin me efektivitet dhe ekonomikitet të Fondeve Buxhetore, nga të cilët janë pranuar plotësisht 7 rekomandime dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 6 në proces zbatimi dhe 1 i pazbatuar;
- Për përmirësimin e gjendjes është lënë, 1 masë disiplinore me 1 rekomandim i cili është pranuar plotësisht dhe është proces zbatimi..



### 7. Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore

Nga auditimi i ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë" për periudhën 01.01.2019 deri më datën 31.12.2021 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 235, datë 16.12.2022, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë në AKBPM me shkresën nr.382/18, datë 16.12.2022, rezulton se:

- Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, duke e dërguar në KLSH me shkresë nr.2814/70 datë 10.01.2023 kjo në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.

- Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, nuk ka përgatitur planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga Titullari brenda afatit 6 mujor, operuar jo në përputhje me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30, pika 2 e tij. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- Për përmirësimin e gjendjes është lënë, 2 propozime për ndryshim apo përmirësim në legjislacionin në fuqi, nga ku janë pranuar plotësisht 2 rekomandime, nga të cilat: 1 zbatuar dhe 1 në proces zbatimi;
- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 41 masa organizative, nga të cilat: 5 janë papranuar; 36 janë pranuar plotësisht, nga të cilat: 14 në proces zbatimi, 16 zbatuar, 4 zbatuar pjesërisht dhe 2 të pazbatuara;
- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 2 masa shpërblim dëmi me 2, të cilat kanë statusin si më poshtë vijon: 1 janë papranuar; 1 është pranuar plotësisht dhe është në proces zbatimi;
- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 2 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike, nga të cilët janë pranuar plotësisht 2 dhe janë në proces zbatimi.

### 8. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së të lëna me shkresën nr.1418/15 datë 19.07.2022 për Raportin Përfundimtar të Auditimit "Për auditimin e përputhshmërisë" të ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, sipas programit të auditimit nr. 1418/1, datë 12.01.2022, për veprimtarinë nga data 01.09.2018 deri me datë 31.12.2021, në lidhje mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afateve dhe niveli i zbatueshmërisë së tyre, koherencën e tyre si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale referuar standardeve të auditimit rezulton se:

- AKBN ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, duke e dërguar në KLSH, kjo në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin Dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.

- AKBN ka përgatitur planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor duke e dërguar në KLSH me shkresë nr.87 prot., datë 09.01.2023, kjo në përputhje me ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- Për përmirësimin e gjendjes është lënë, 1 masë për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi me 1 rekomandim, i cili është pranuar plotësisht dhe është i zbatuar;
- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 52 masa organizative, nga ku janë pranuar plotësisht 52 rekomandime, nga të cilat; 36 Zbatuar, 2 pa zbatuar, 10 në proces zbatimi dhe 4 zbatuar pjesërisht;
- Për përmirësimin e gjendjes është lënë, 1 masë për menaxhimin me efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve buxhetore, i cili është pranuar plotësisht dhe është i zbatuar;
- Për përmirësimin e gjendjes është lënë, 1 masë disiplinore, i cili është pranuar plotësisht dhe është 1 zbatuar.



### 9. Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural

Nga auditimi i ushtruar në Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi auditimin financiar dhe përputhshmëri" për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2019 deri në 31.03.2021 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr.156, datë 12.10.2021, të Kryetarit të KLSH-së, rezultoi se:

- Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural ka miratuar miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, duke e dërguar në KLSH, kjo në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.

- Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse ka përgatitur planin e veprimit 6 mujor dhe dërguar në KLSH në përputhje me ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 40 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 40

rekomandime, të cilat kanë statusin e zbatimit si vijon: 28 zbatuar, 3 të pazbatuar, 7 në proces zbatimi dhe 2 zbatuar pjesërisht;

b) Për përmirësimin e gjendjes është lënë, 1 masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin dhe menaxhimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publikeme 2 rekomandime, nga të cilat janë pranuar plotësisht 2 rekomandime dhe kanë statusin e zbatimit si vijon: 2 në proces zbatimi.

c) Për përmirësimin e gjendjes është lënë, 1 masë disiplinore me 1 rekomandim, i cili është pranuar plotësisht dhe ka statusin e zbatimit si vijon: 1 zbatuar.

### 10. Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut

Nga auditimi i ushtruar në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi auditimin tematik" për periudhën 01.01.2021 deri më datën 30.06.2022 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr.201, datë 18.10.2022, të Kryetarit të KLSH-së, verifikohet se:

- Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, duke e dërguar në KLSH, kjo në përputhje me me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin Dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.

- Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipasstrukturave përgjegjëse ka përgatitur planin e veprimit, kjo në përputhje me ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 4 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 4 dhe janë zbatuar 4.

b) Për përmirësimin e gjendjes është lënë, 1 masë disiplinore, i cili është pranuar plotësisht dhe është i zbatuar.



### 11. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë" për periudhën 01.01.2019 deri më datën 31.06.2021 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 34, datë 03.03.2022, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1020/8, datë 08.03.2022, rezulton se:

- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, kjo në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.

- Drejtoria e Përgjithshme të Policisë së Shtetit në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, nuk ka përgatitur planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga Titullari brenda afatit 6 mujor, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30, pika 2 e tij. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 21 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 21 rekomandime të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 15 Zbatuar, 3 pa zbatuar dhe 3 në proces zbatimi;
- b) Për përmirësimin e gjendjes është lënë, 1 masë shpërblim dëmi, i cili është pranuar plotësisht dhe është zbatuar;
- c) Për përmirësimin e gjendjes është lënë, 1 masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin dhe menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike me, i cili është pranuar plotësisht dhe është zbatuar.
- d) Për përmirësimin e gjendjes është lënë, 1 masë administrative (për të cilin nuk janë shprehur në plan veprimi), i cili ka statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 1 në proces zbatimi.
- e) Për përmirësimin e gjendjes është lënë, 1 masë disiplinore, i cili është pranuar plotësisht dhe është i pa zbatuar.

### 12. Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Nga auditimi i ushtruar në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë" për periudhën e veprimtarisë nga data 01.08.2019 deri në 31.12.2021 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 191, datë 05.10.2022, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1419/20 prot., datë 05.10.2022 rezulton se:

- Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, kjo në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.

- Në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka përgatitur planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, kjo në përputhje me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 42 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 7 rekomandime të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 4 Zbatuar, 3 në proces zbatimi;
- b) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 21 masa shpërblim dëmi, nga të cilat janë pranuar plotësisht 19 rekomandime dhe nuk janë pranuar 2 masa, të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 19 zbatuar;
- c) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 12 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike, nga të cilat nuk janë pranuar 12 rekomandime;
- d) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 9 masa administrative me 1 rekomandim, i cili nuk është pranuar;
- e) Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 masë disiplinore, me 1 rekomandim, i cili nuk është pranuar.



### 13. Cirku i Tiranës

Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë e Kulturës dhe Cirkun Kombëtar, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi auditimin tematik" për periudhën 01.01.2019 deri në 30.09.2021, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr.89, datë 02.06.2022, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr 1129/22 prot., datë 06.06.2022, rezulton se:

-Ministria e Kulturës ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, kjo në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.

- Në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, Ministria e Kulturës ka përgatitur planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, kjo në përputhje me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 6 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 6 rekomandime, të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 5 Zbatuar, 1 në proces zbatimi;

b) Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 masë shpërblim dëmi, i cili është pranuar plotësisht dhe ka statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 1 në proces zbatimi;

c) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 2 masa disiplinore, nga të cilat 2 janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 1 zbatuar, 1 pa zbatuar.

irësimin e gjendjes është lënë, 1 masë disiplinore, i cili është pranuar plotësisht dhe është i pa zbatuar.

### 14. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi auditimin e përputhshmërisë" për periudhën 01.01.2018 deri më datën 30.06.2021 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr.57, datë 07.04.2022, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr.935/13 prot., datë 11.04.2022, rezulton se:

- Drejtoria e Përgjithshme të Shërbimit të Provës ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, kjo në përputhje me me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.

- Drejtoria e Përgjithshme të Shërbimit të Provës në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, DPSHP ka përgatitur planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor por nuk e ka dërguar me shkresë pranë KLSH-së, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" pika 2 e nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 28 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 28 rekomandime, të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 27 Zbatuar, 1 pa zbatuar;

b) Për përmirësimin e gjendjes është lënë, 1 masë shpërblim dëmi, i cili është pranuar plotësisht dhe është në proces zbatimi;

c) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 4 masa për menaxhimin me efektivitet dhe Ekonomicitet të Fondeve Buxhetore, nga të cilat janë pranuar plotësisht 4 rekomandime dhe janë zbatuar 4.

d) Për përmirësimin e gjendjes është lënë, 1 masë disiplinore e cila është pranuar plotësisht dhe është zbatuar.



### 15. Institucioni Rezidencial i Përkujdesit Shoqëror për Fëmijë, "Zyber Hallulli"

Nga auditimi i ushtruar në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, "Zyber Hallulli", për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi Përputhshmërinë e Veprimtarisë dhe Auditimin Financiar" për periudhën 01.09.2019 deri në 31.12.2021 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 170, datë 20.09.2022, të Kryetarit të KLSH-së, të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 381/7 prot., datë 20.09.2022, rezulton se:

- Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, "Zyber Hallulli" ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, kjo në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.

- Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, "Zyber Hallulli" në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, nuk ka dërguar në KLSH planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 1 masë për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi, i cili është pranuar plotësisht dhe është zbatuar;
- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 27 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 27 rekomandime dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 13 zbatuar, 11 në proces zbatimi, 1 i pazbatuar, 2 zbatuar pjesërisht;
- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 6 masa për menaxhimin me efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve Buxhetore, nga të cilat janë pranuar plotësisht 6 rekomandime dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 5 pazbatuar dhe 1 në proces zbatimi;
- Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 masë disiplinore, i cili është i pranuar plotësisht dhe është i pazbatuar.

### 16. Bashkia Vlorë (Deinstitutionalizimi)

Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Vlorë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi Auditimin e Përputhshmërisë dhe Vlerësues me fokus Plani Kombëtar të Deinstitutionalizimit të Fëmijëve 2020 - 2022" për periudhën 01.09.2020 deri më 30.11.2021 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 93, datë 03.06.2022, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1267/23 datë 07.06.2022, rezulton se:

- Bashkia Vlorë nuk ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 15, shkronja j.

- Bashkia Vlorë në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, nuk ka përgatitur planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 5 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 5 rekomandime dhe janë zbatuar 5 masat;
- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 2 masa shpërblim dëmi me 3 rekomandime, nga të cilat janë pranuar plotësisht 3 rekomandime të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 1 zbatuar dhe 2 të pazbatuar;
- Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 masë disiplinore me 1 rekomandim, i cili është pranuar dhe ka statusin e zbatimit të ecurisë si vijon: 1 i pazbatuar.



### 17. Bashkia Korçë (Deinstitucionalizimi)

Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Korçë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë" për periudhën e veprimtarisë nga data 01.09.2020 deri në 30.11.2021 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr.93 datë 03.06.2022, të Kryetarit të KLSH-së, të cilat janë përcjellë me shkresën nr 1267/24 prot., datë 07.06.2022, rezulton se:

- Bashkia Korçë ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, kjo në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.

- Në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse Bashkia Korçë ka përgatitur planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, kjo në përputhje me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 3 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 3 dhe janë zbatuar 3 masa;
- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 4 masa shpërblim dëmi, nga të cilat janë pranuar plotësisht 4 rekomandime dhe janë zbatuar 4 masat.
- Për përmirësimin e gjendjes është lënë, 1 masë disiplinore, i cili është pranuar plotësisht dhe është zbatuar.

### 18. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit - AKU, Inspektorati Qendror - IQ dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit - AKSHI

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të dërguara me shkresën nr.978/14 prot, datë 13.03.2022, drejtuar AKU-s, me shkresën nr.978/12 prot, datë 30.03.2022 drejtuar AKSHI-t dhe me shkresën nr.978/13 prot, datë 30.03.2022, drejtuar IQ-s, rezultoi si më poshtë:

- Subjektet (AKU, IQ dhe AKSHI) nuk kanë miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.

- Në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse të subjekteve nuk kanë përgatitur planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 33 masa organizative. Nga masat organizative janë pranuar plotësisht 31 masa, nga të cilat janë zbatuar 15 masa, janë në proces zbatimi 9 masa, janë zbatuar pjesërisht 2 masa dhe janë pa zbatuar 5 masa organizative.

### 19. Agjencia e Prokurimit Publik - APP dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit - AKSHI

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të dërguara me shkresën nr. 15/11 prot, datë 01.07.2022 drejtuar APP-s dhe me shkresën nr. 15/12 prot, datë 01.07.2022, drejtuar AKSHI-t, rezultoi si më poshtë:

- Subjektet (APP dhe AKSHI) nuk kanë miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.

- Në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse subjektet nuk kanë përgatitur planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 18 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 17 masa organizative. Nga masat e pranuar, janë zbatuar 12 masa, janë në proces zbatimi 3 masa dhe janë zbatuar pjesërisht 2 masa organizative.



### 20. Agjencia Shtetërore e Kadastrës - ASHK

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të dërguara subjektit ASHK me shkresën nr. 287/7 prot, datë 22.09.2022, rezultoi se subjekti i ka trajtuar rekomandimet e lëna nga auditimi i KLSH dhe në lidhje me to ka zbatuar si më poshtë vijon:

- ASHK nuk ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.
- Në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse ASHK nuk ka përcjellë planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 33 masa organizative. Nga 33 masat organizative janë zbatuar 4 masa dhe nuk janë zbatuar 29.
- b) Për përmirësimin e gjendjes është lënë, 1 masë administrative, e cila është zbatuar.
- c) Për përmirësimin e gjendjes është lënë, 1 masë shpërblym dëmi, e cila është nuk zbatuar.
- d) Për përmirësimin e gjendjes është lënë, 1 masë disiplinore, e cila është nuk zbatuar.

### 21. Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A - SHRUKD

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të dërguara subjektit SHRUKD me shkresën nr. 817/7 prot, datë 22.12.2022, rezultoi se subjekti i ka trajtuar rekomandimet e lëna nga auditimi i KLSH dhe në lidhje me to ka zbatuar si më poshtë vijon:

- Shoqëria rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës SHA ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.
- Në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime Durrës SHA nuk ka përcjellë planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 20 masa organizative. Nga masat organizative janë pranuar plotësisht 20 masa, nga të cilat 8 masa janë zbatuar, janë në proces zbatimi 1, zbatuar pjesërisht 1 masë.

### 22. Universitetet e Tiranës, "Ismail Qemali" Vlorë, "Luigj Gurakuqi" Shkodër

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të dërguara subjektit UT, UV me shkresën nr. 468/22 prot, 468/21 prot, nr. 468/20 prot, datë 22.12.2022, rezultoi se subjektet i kanë trajtuar rekomandimet e lëna nga auditimi i KLSH dhe në lidhje me to ka zbatuar si më poshtë vijon:

- Universiteti i Tiranës, "Ismail Qemali" Vlorë, dhe ai i Shkodrës, "Luigj Gurakuqi" kanë miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.
- Në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse Universitetet nuk kanë përcjellë planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:



- a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 44 masa organizative. Nga 44 masat organizative janë pranuar plotësisht 44, nga të cilat 6 zbatuar plotësisht, 1 pjesërisht, 25 masa në proces zbatimi dhe 12 masa nuk janë zbatuar.
- b) Për përmirësimin e gjendjes është lënë, 1 masë për shpërblim dëmi, e cila është e pa pranuar.
- c) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 3 masa për menaxhimin me efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve buxhetore, nga të cilat janë pranuar 2 masa dhe janë në proces zbatimi dhe nuk është pranuar 1 masë.

### **23. Për auditimin e performancës me temë "Performanca e institucioneve rezidenciale të përkujdesit shoqëror për fëmijë"**

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit miratuar me Vendimin nr. 19, datë 19.01.2022 të Kryetarit të KLSH-së, dërguar subjekteve të auditimit, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën nr. 505/35 prot., datë 24.01.2022, Shërbimit Social Shtetëror me shkresën nr. 505/36 prot, datë 24.01.2022, Bashkisë Durrës me shkresën nr. 505/39 prot, datë 24.01.2022, Bashkisë Shkodër me shkresën nr. 505/41 prot, datë 24.01.2022, Bashkisë Vlorë me shkresën nr. 505/40 prot, datë 24.01.2022, Bashkisë Korçë, me shkresën nr. 505/38 prot, datë 24.01.2022 dhe Bashkisë Sarandë me shkresën nr. 505/37 prot, datë 24.01.2022, rezultoi se:

- subjektet kanë miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 15, shkronja j.

#### *Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh*

Në zbatim të nenit 15, shkronja "j" të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për informimin e KLSH-së, mbi respektimin e afatit ligjor prej 20 ditësh, mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale: ka respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh për informimin e KLSH - së mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Shërbimi Social Shtetëror: ka respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh për informimin e KLSH - së mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

#### *Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh*

Në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i cili përcakton se: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna" rezultoi se:

MSHMS: në planin e saj të masave ka kërkuar rishikim afatesh, nga ato të lëna nga grupi i auditimit, dhe duke qenë se ka qenë në proces zbatimi, nuk ka përcjellë pranë KLSH një raport 6-mujor. Gjithashtu ka rezultuar se nuk kanë respektuar afatin ligjor prej 6 muajsh për raportim në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, Bashkitë Vlorë, Shkodër, Durrës, Sarandë dhe Korçë.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë gjithsej 32 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht. Nga 32 masat e dhëna, janë zbatuar plotësisht 21, pjesërisht 8, në proces zbatimi 1 dhe nuk janë zbatuar 2 masa.



### 24. Për auditimin e performancës me temë "Gjobat për shkelje të kodit rrugor vendosur nga policia e shtetit"

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit miratuar me Vendimin nr. 233, datë 30.12.2021 të Kryetarit të KLSH-së të dërguara në subjekteve të auditimit, Ministrinë e Brendshme me shkresën nr. 611/10 prot., datë 21.01.2022 si dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit me shkresën nr. 611/11 prot., datë 21.01.2022 rezultoi si vijon:

#### *Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh*

Në zbatim të nenit 15, shkronja "j" të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për informimin e KLSH-së, mbi respektimin e afatit ligjor prej 20 ditësh, mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Ministria e Brendshme: nuk ka respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh për informimin e KLSH - së mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit: nuk ka respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh për informimin e KLSH - së mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

#### *Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh*

Në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i cili përcakton se: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna", rezultoi se:

Ministria e Brendshme: institucioni nuk ka respektuar afatin ligjor prej 6 muajsh për raportim në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit: nuk ka respektuar afatin ligjor prej 6 muajsh për raportim në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë gjithsej 17 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht. Nga 17 masat e dhëna, janë zbatuar plotësisht 8, pjesërisht 3, në proces zbatimi 1 dhe nuk janë zbatuar 5 masa

### 25. Për auditimin e performancës me temë "Performanca e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri në Shqipëri"

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit miratuar me Vendimin nr. 13 datë 20.01.2022 të Kryetarit të KLSH-së përcjellë subjekteve të audituar me shkresat nr. 610/12-14, datë 21.01.2022 rezultoi se:

#### *Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh,*

Në zbatim të nenit 15, shkronja "j" të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për informimin e KLSH-së, mbi respektimin e afatit ligjor prej 20 ditësh, mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri në MB: ka respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh për informimin e KLSH - së mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Bashkia Vlorë dhe Bashkia Tiranë, nuk kanë nuk ka respektuar afatin ligjor prej 6 muajsh për raportim në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna.



### *Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh.*

Në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i cili përcakton se: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna", rezultoi se:

Ministria e Brendshme – Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri: ka respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh për informimin e KLSH – së mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Subjektet Bashkia Tiranë dhe Bashkia Vlorë nuk kanë respektuar afatin ligjor prej 6 muajsh, për të raportuar mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë gjithsej 63 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht. Nga 63 masat e pranuar, janë zbatuar plotësisht 15, pjesërisht 6, në proces zbatimi 30 dhe nuk janë zbatuar 12 masa.

### **26. Për auditimin e performancës me temë "Efektiviteti i programeve për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore 2019"**

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit dërguar në, ish-Ministrinë e Shtetit për Rindërtimin aktualisht Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 200/34, datë 26.01.2022, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 200/32, datë 26.01.2022, Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile me shkresën nr. 200/31, datë 26.01.2022, Bashkinë Tiranë me shkresën nr. 200/33, datë 26.01.2022, Bashkinë Durrës me shkresën nr. 200/29, datë 26.01.2022 rezultoi se:

### *Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh,*

Në zbatim të nenit 15, shkronja "j" të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për informimin e KLSH-së, mbi respektimin e afatit ligjor prej 20 ditësh, mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Ministria e Shtetit për Rindërtimin (aktualisht Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë): ka respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh për informimin e KLSH – së mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë: ka respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh për informimin e KLSH – së mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile: ka respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh për informimin e KLSH – së mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Bashkia Tiranë: Nga auditimi u konstatua se Bashkia Tiranë, nuk ka respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh për informimin e KLSH – së mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Bashkia Durrës: nuk ka respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh për informimin e KLSH – së mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

### *Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh,*

Në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i cili përcakton se: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna", rezultoi se:

Ministria e Shtetit për Rindërtimin (aktualisht Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë): nuk ka respektuar afatin ligjor 6 muaj për informimin e KLSH – së mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë: nuk ka respektuar afatin ligjor 6 muaj për informimin e KLSH – së mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile: nuk ka respektuar afatin ligjor 6 muaj për informimin e KLSH – së mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Bashkia Tiranë: nuk ka respektuar afatin ligjor 6 muaj për informimin e KLSH – së mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Bashkia Durrës: nuk ka respektuar afatin ligjor 6 muaj për informimin e KLSH – së mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.



Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë gjithsej 34 masa organizative, nga të cilat janë pranuar 24 dhe janë pa pranuar 10. Nga 24 masat e pranuar, janë zbatuar plotësisht 12, pjesërisht 1, në proces zbatimi 5 dhe nuk janë zbatuar 6 masa.

### **27. Për auditimin e performancës me temë "Të drejtat e pasagjerëve në transportin ajror"**

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit i dërguar në Autoritetin e Aviacionit Civil, me shkresën nr. 726/6, datë 30.03.2022. rezultoi se:

*Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh,*

Në zbatim të nenit 15, shkronja "j" të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për informimin e KLSH-së, mbi respektimin e afatit ligjor prej 20 ditësh, mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Autoriteti i Aviacionit Civil: nuk ka respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh për informimin e KLSH - së mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

*Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh,*

Në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i cili përcakton se: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna", rezultoi se:

Autoriteti i Aviacionit Civil: nuk ka respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh për informimin e KLSH - së mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë gjithsej 18 masa organizative, nga të cilat janë pranuar 17 dhe nuk është pranuar 1 masë. Nga 17 masat e pranuar, janë zbatuar plotësisht 7, pjesërisht 2, në proces zbatimi 6 dhe nuk janë zbatuar 2 masa.

### **28. Për auditimin e performancës me temë "Përdorimi i produkteve për mbrojtjen e bimëve në bujqësi dhe siguria ushqimore"**

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit miratuar me Vendimin nr. 55 datë 06.04.2022 të Kryetarit të KLSH-së, si dhe u janë përcjellë subjekteve të audituara, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë me shkresat nr. 649/9, /10, /11 prot, datë 07.04.2022 rezultoi se:

*Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh,*

Në zbatim të nenit 15, shkronja "j" të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për informimin e KLSH-së, mbi respektimin e afatit ligjor prej 20 ditësh, mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, AKU dhe ISUV: kanë respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh për informimin e KLSH - së mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

*Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh,*

Në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i cili përcakton se: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna", rezultoi se:

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural: ka respektuar afatin ligjor prej 6 muajsh për raportim në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Agjencia Kombëtare e Ushqimit: ka respektuar afatin ligjor prej 6 muajsh për raportim në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna.



Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë: ka respektuar afatin ligjor prej 6 muajsh për raportim në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë gjithsej 18 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht. Nga 18 masat e pranuar, janë zbatuar plotësisht 12 dhe janë në proces zbatimi 6.
- Për përmirësimin e gjendjes janë dhënë gjithsej 9 masa për propozime për përmirësime ligjore, të cilat janë pranuar dhe zbatuar plotësisht.

### **29. Për auditimin e performancës me temë "Efektiviteti i politikave mjedisore në NJVQV"**

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit miratuar me Vendimin nr. 110 datë 30.06.2022 të Kryetarit të KLSH-së dërguar subjekteve të audituara me shkresat nr. 976/19 prot, datë 30.06.2022, rezultoi se:

#### *Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh*

Në zbatim të nenit 15, shkronja "j" të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për informimin e KLSH-së, mbi respektimin e afatit ligjor prej 20 ditësh, mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Bashkia Tiranë: ka respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh për informimin e KLSH - së mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Bashkia Lezhë: nuk ka respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh për informimin e KLSH - së mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Bashkia Shkodër: ka respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh për informimin e KLSH - së mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Bashkia Fier: ka respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh për informimin e KLSH - së mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Bashkia Vlorë: nuk ka respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh për informimin e KLSH - së mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Bashkia Pogradec: nuk ka respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh për informimin e KLSH - së mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Bashkia Korçë: ka respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh për informimin e KLSH - së mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

#### *Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh*

Në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i cili përcakton se: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna", rezultoi se:

Bashkia Tiranë: nuk ka respektuar afatin ligjor prej 6 muajsh për raportim në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Bashkia Lezhë: nuk ka respektuar afatin ligjor prej 6 muajsh për raportim në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Bashkia Shkodër: nuk ka respektuar afatin ligjor prej 6 muajsh për raportim në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Bashkia Fier: nuk ka respektuar afatin ligjor prej 6 muajsh për raportim në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Bashkia Vlorë: ka respektuar afatin ligjor prej 6 muajsh për raportim në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Bashkia Pogradec: nuk ka respektuar afatin ligjor prej 6 muajsh për raportim në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Bashkia Korçë: ka respektuar afatin ligjor prej 6 muajsh për raportim në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna.



Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë gjithsej 15 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht. Nga 15 masat e pranuar, janë zbatuar plotësisht 3 dhe pjesërisht 6 masa.

### 30. Për auditimin e performancës me temë "Incineratori i Tiranës"

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit të dërguara në subjekteve të auditimit, Në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit me shkresën 1142/29 datë 06.07.2022; Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, me shkresën 1142/28 datë 06.07.2022; Bashkinë Tiranë me shkresën 1142/27 datë 06.07.2022 rezultoi se:

#### *Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh,*

Në zbatim të nenin 15, shkronja "j" të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për informimin e KLSH-së, mbi respektimin e afatit ligjor prej 20 ditësh, mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit: nuk ka respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh për informimin e KLSH – së mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë: ka respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh për informimin e KLSH – së mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Bashkia Tiranë: ka respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh për informimin e KLSH – së mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

#### *Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh,*

Në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i cili përcakton se: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna", rezultoi se:

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit: nuk ka respektuar afatin ligjor prej 6 muajsh për raportim në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë: nuk ka respektuar afatin ligjor prej 6 muajsh për raportim në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Bashkia Tiranë: nuk ka respektuar afatin ligjor prej 6 muajsh për raportim në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë

a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë gjithsej 16 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht. Nga 16 masat e pranuar, janë zbatuar plotësisht 7, janë në proces zbatimi 6 dhe nuk janë zbatuar 3 masa.

b) Për përmirësimin e gjendjes është dhënë gjithsej 1 masë për propozim për përmirësim ligjore, e cila është pranuar plotësisht dhe është në proces zbatimi.



### **31. Për auditimin e performancës me temë "Efektiviteti i programit të integruar për zhvillimin rural, programi i 100 fshatrave"**

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit miratuar me Vendimin nr. 148, datë 09.09.2022 të Kryetarit të KLSH-së dërguar subjekteve të audituara Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Kulturës, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural me shkresat nr.108/19-24, datë 09.09.2022, rezultoi se:

#### *Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh*

Në zbatim të nenit 15, shkronja "j" të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për informimin e KLSH-së, mbi respektimin e afatit ligjor prej 20 ditësh, mbi planin e veprimit të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna, rezultoi se subjektet që kanë respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh duke informuar KLSH-në mbi planin e masave janë:

MBZHR: ka respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh për informimin e KLSH - së mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

AZHBR: ka respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh për informimin e KLSH - së mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

#### *Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh*

Në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i cili përcakton se: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna" rezultoi se, subjektet nuk kanë respektuar afatin ligjor prej 6 muajsh për raportim në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë gjithsej 20 masa organizative, nga të cilat janë pranuar 17 dhe nuk janë pranuar 3 masa. Nga 17 masat e pranuar, janë zbatuar plotësisht 6, pjesërisht 1, në proces zbatimi 1 dhe nuk janë zbatuar 9 masa.

### **32. Për auditimin e performancës me temë "Efektiviteti i menaxhimit të sistemit të identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve - RUDA/sigurisë ushqimore e veterinarisë"**

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit dërguar subjekteve të audituara, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrotjtjes së Bimëve, (AKVMB), Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, (AKU) si dhe Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV), me shkresën nr. 99/13, datë 12.09.2022 rezultoi se:

#### *Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh*

Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna, rezultoi se: MBZHR ka respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh për informimin e KLSH - së mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

#### *Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh*

Në zbatim të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" rezultoi se, MBZHR ka respektuar afatin ligjor prej 6 muajsh për raportim në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:



- a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë gjithsej 31 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht. Nga 31 masat e pranuar, janë zbatuar plotësisht 23, pjesërisht 1, në proces zbatimi 7 masa.
- b) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 4 masa për menaxhimin me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve, të cilat janë pranuar plotësisht. Nga 4 masat e pranuar, janë zbatuar plotësisht 2, dhe nuk janë zbatuar 2.
- c) Për përmirësimin e gjendjes janë dhënë gjithsej 5 masa për propozime për përmirësime ligjore, të cilat janë pranuar plotësisht. Nga 5 masat e pranuar, është zbatuar plotësisht 1, në proces zbatimi 2 dhe pa zbatuar 2 masa.

### 33. Për auditimin e performancës me temë "Menaxhimi i terreneve sportive"

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit miratuar me Vendimin nr. 161 datë 16.09.2022 të Kryetarit të KLSH-së, dërguar subjekteve të audituara, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Bashkitë Kurbin, Librazhd, Prrenjas dhe Pogradec, me shkresat nr. 104/14/15/16/17/18 prot., datë 19.09.2022, rezultoi se:

#### *Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh*

Në zbatim të nenit 15, shkronja "j" të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për informimin e KLSH-së, mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Ministria e Arsimit dhe Sportit: nuk ka respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh për informimin e KLSH - së mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Bashkia Kurbin: nuk ka respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh për informimin e KLSH - së mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Bashkia Librazhd: nuk ka respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh për informimin e KLSH - së mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Bashkia Prrenjas: nuk ka respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh për informimin e KLSH - së mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Bashkia Pogradec: nuk ka respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh për informimin e KLSH - së mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

#### *Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh*

Në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i cili përcakton se: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna", rezultoi se:

Ministria e Arsimit dhe Sportit: nuk ka respektuar afatin ligjor prej 6 muajsh për raportim në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Bashkia Kurbin: nuk ka respektuar afatin prej 6 muajsh, për raportim në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Bashkia Librazhd: nuk ka respektuar afatin prej 6 muajsh, për raportim në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Bashkia Prrenjas: nuk ka respektuar afatin prej 6 muajsh, për raportim në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Bashkia Pogradec: nuk ka respektuar afatin prej 6 muajsh, për raportim në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë gjithsej 24 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht. Nga 24 masat e pranuar, janë zbatuar plotësisht 8, pjesërisht 4, në proces zbatimi 2 dhe nuk janë zbatuar 10 masa.



### 34. Për auditimin e performancës me temë “Mbrotjtja dhe administrimi i monumenteve të kulturës”

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit me Vendimin nr. 166, datë 19.09.2022 të Kryetarit të KLSH-së dërguar në Ministrinë e Kulturës me shkresën nr. 100/9 prot., datë 19.09.2022 rezultoi se:

#### *Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh*

Në zbatim të nenit 15, shkronja "j" të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për informimin e KLSH-së, mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna: Ministria e Kulturës ka respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh për informimin e KLSH - së mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

#### *Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh*

Në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i cili përcakton se: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna", rezultoi se: Ministria e Kulturës nuk ka respektuar afatin ligjor prej 6 muajsh për raportimin në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë gjithsej 22 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht. Nga 22 masat e pranuar, janë zbatuar plotësisht 6, pjesërisht 2, në proces zbatimi 7 dhe nuk janë zbatuar 7 masa.
- Për përmirësimin e gjendjes është dhënë gjithsej 1 masë për propozim për përmirësim ligjor, e cila është pranuar plotësisht dhe nuk është zbatuar.

### 35. Për auditimin e performancës me temë “Menaxhimi i burimeve ujore”

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit të dërguara në subjektet subjektet, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit me shkresat nr. 107/12 prot, 107/13 prot, nr. 107/14 datë 22.09.2022, rezultoi se:

#### *Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh*

Në zbatim të nenit 15, shkronja "j" të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për informimin e KLSH-së, mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna, rezultoi se:

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural: ka respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh për informimin e KLSH - së mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore: ka respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh për informimin e KLSH - së mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Agjencia Kombëtare të Mjedisit: nuk ka respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh për informimin e KLSH - së mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

#### *Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh*

Në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i cili përcakton se: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna", rezultoi se:

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural: nuk ka respektuar afatin prej 6 muajsh, për raportim në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore: ka respektuar afatin prej 6 muajsh, për raportim në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Agjencia Kombëtare të Mjedisit: nuk ka respektuar afatin prej 6 muajsh, për raportim në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.



Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë gjithsej 22 masa organizative, nga të cilat janë pranuar 22 dhe nuk është pranuar 1 masë. Nga 21 masat e pranuar, janë zbatuar plotësisht 12, pjesërisht 1, në proces zbatimi 7 dhe nuk janë zbatuar 7 masë.
- b) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 2 masa për menaxhimin me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve, të cilat janë pranuar plotësisht. Nga 2 masat e pranuar, është zbatuar plotësisht 1 masë, dhe në proces zbatimi 1 masë.
- c) Për përmirësimin e gjendjes janë dhënë gjithsej 2 masa për propozime për përmirësime ligjore, të cilat janë pranuar plotësisht. Nga 2 masat e pranuar, është zbatuar plotësisht 1, dhe është në proces zbatimi 1 masë.

### **36. Për auditimin e performancës me temë "Tirana e gjelbër"**

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit miratuar me Vendimin nr. 175 datë 22.09.2022 të Kryetarit të KLSH-së, për Bashkinë Tiranë dhe njësitë e varësisë, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zvillimit të Territorit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, pjesë e Auditimit të Performancës me temë: "Tirana e Gjelbër", dërguar subjekteve me shkresën nr. 974/12 prot, datë 03.10.2022 rezultoi se:

#### *Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh*

Në zbatim të nenit 15, shkronja "j" të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për informimin e KLSH-së, mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Bashkia Tiranë dhe njësitë e varësisë nuk kanë respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh për informimin e KLSH - së mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna megjithëse nga verifikimi në terren u konstatua se Bashkia Tiranë ka nxjerrë Urdhër i Brendshëm nr. Prot. 40637, datë 16.11.2022, për "Zbatimin e rekomandimeve për auditimin e performancës me temë "Tirana e gjelbër", dhe janë ngarkuar personat për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete.

Bashkia Tiranë dhe njësitë e varësisë nuk kanë respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh për informimin e KLSH - së mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna megjithëse nga verifikimi në terren u konstatua se Bashkia Tiranë ka nxjerrë Urdhër i Brendshëm nr. Prot. 40637, datë 16.11.2022, për "Zbatimin e rekomandimeve për auditimin e performancës me temë "Tirana e gjelbër", dhe janë ngarkuar personat për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete.

#### *Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh*

